**Predrag Grbic:** Të nderuari, zëvendësit e kryetarit, këshilltar, drejtorët të drejtorive, përfaqësuesit e OSEB-ës, dhe të gjithë të tjerë të pranishëm, mirëdita dhe mirë se erdhët në seancën s dytë të rregullt të KK Shtërpçe. Në kuvendin e sotshëm marrin pjesë të gjithë 15 anëtarët, që do të thotë se kemi kuorumin dhe mund të fillojmë me punë. Pasi kemi dërguar ftesat e kemi marr një propozim për plotësimin e rendit të ditës, nuk kemi mundur të dërgojmë kur kemi dërguar material për Kuvend, sepse ne kanë nevojitur edhe disa detajet. Unë e qes si plotësim e rendit të ditës, transferim e mjeteve pa shpenzuar nga viti 2017 në vitin 2018. Buxheti përmbahet nga grandet dhe të hyrat vetanake, dhe të gjitha mjete të cilat nuk shpenzohen gjatë vitit e kaluar kthehen në Ministri e Financave, përveç mjete nga hyrat vetanake. A lumërohet dikush për fjalë lidhur me këtë propozimin, për plotësimin e rendit të ditës? Pasi nuk lajmërohet askush, qes në votim këtë pik, që bëhet pika nr.7. kush është për. Konstatohet se me njëzëri kemi aprovua që ky propozimi gjendet në rendin e ditës

Tani po qes në votim rendin e ditës me këtë plotësim. Kush është për?

**Rifat Rustemi:** Kish dashur të na jepni mundësi që edhe na të propozojmë një pik të rendit të ditës. Ne e dimë rendësin e transferim e mjeteve pa shpenzuar, por ndoshta edhe na kemi dashur të propozojmë diçka..

**Predrag Grbic:** Kur është fjala për rendin e ditës, ai mundet të plotësohet me 1/3 vota e këshilltareve, dhe mund të plotësohet gjatë Kuvendit, por, vetëm nëse ajo pika është në interes e gjithë qytetareve e komunës së tonë, nuk mund të plotësohet rendi i ditës me diçka çka është

me interes personal. A lumërohet dikush për fjalë? Nëse jo, qes përsëri në votim rendin e ditës. Kush është për?

Konstatoj se me njëzëri kemi aprovua rendin e ditës

## **2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga seanca e kaluar e K.K Shtërpce**

**Predrag Grbic:** A lajmërohet dikush për fjalë e lidhur me procesverbalin?

**Rifat Rustemi:** Sa për procesverbal, ky proces është pak problem nëse e lexon një qytetar e komunës së Shtërpçës, i cili donë më dit si është zhvilluar ky takimi, ka pak problem më kuptua esencën e takimit për arsye se nuk është kontradikt, edhe fjala e juve kur e keni thonë që kryesuesi i kuvendit më automatizëm është edhe kryesuesi i komitetit për politik dhe financa këtu është shënuar e kundërta që kryesuesi i komitetit për politik dhe financa është më automatizëm dhe kryesuesi i kuvendit, edhe më një pik e rendit të ditës unë kam votuar kundër dhe këtu po shkruan që një këshilltar nuk ka votuar, unë ose votoj për, ose kundër, ose abstenoj a nuk ndoll së nuk votoj. Unë di së nuk mundet me qenë perfekt, ndoshta kish qenë mirë që të na shpërndani incizimin, ose me pas kujdes.

**Predrag Grbic:** Mund të them se di shumë mirë se si punon sekretar për punë e Kuvendit, ai e shkruan fjalë për fjalë të gjitha që janë biseduar në Kuvend. Unë e kam lexuar versionin në gjuhen serbe dhe aji është mirë. Ndoshta ka pasur disa gabime në gjuhen shqipe, dhe ato do të korrigjohen dhe do të mundohemi mos më ndoll gabimet të tilla. A lajmërohet edhe dikush për fjalë? Pasi nuk lajmërohet askush qes në votim.

Konstatoj se me njëzëri kemi aprovua procesverbalin

## **3. Zgjedhja e zëvendësit e kryesuesit për komunitete**

**Predrag Grbic:** Ky është kuvendi I tret, nëse e llogaritet dhe kuvendin i inaugurimit, dhe deri tani nuk e kemi zëvendësin e kryesuesit për komunitete. Në ligj për vetëqeverisje lokale thuhet që zëvendësi për komunitete është këshilltar që vjen nga rrallat e komunitetit pakicë, të cila e numëron më shumë si 10% banoret në atë komunë, për të cilën është fjala, dhe i cili ka marr më shumë vota në zgjedhjet lokale. Ne kemi një situatë e veçantë, dy këshilltar kanë të njëjtin numër votash, 949. Në kuvendin e paraprak kjo pika nuk ka qenë në rendin e ditës, sepse nuk e kemi pasur marrëveshje ,por tani kemi vendosur që të vendosem në rendin e ditës, më shpresë se do të arrimë një marrëveshje mes këtyre dy kandidatëve. Për këtë çështje jemi drejtuar MAVL-ës dhe kemi kërkuar mendimin e tyre, mendimi i tyre nuk është bazuar në ligjin për Vetëqeverisje Lokale , por ka qenë vetëm propozimi e tyre si të zgjidhim këtë problem. Unë e kam mbajtur premtimin dhe u takova me të dy kandidatët, por për fat keq nuk është bërë asnjë marrëveshje. Nuk kishte asnjë marrëveshje politike, dhe to dy kandidat nuk janë pajtuar për short. Një kandidat po pajtohet a tjetri jo , ashtu që unë si kryesuesi i Kuvendit, jam më një pozitë jo lakmueshme dhe nuk di çka të bëj. Për ata kam vendosur që të hapi një diskutim për këtë çështje. Para së ta fillojmë më diskutimin , ndoshta kandidatet e kanë ndryshuar vendimin e tyre, a të japim një pushim, që ata takohen edhe një here në katër sy, ose nuk ka nevojë për këtë?

**Rifat Rustemi:** Unë jam takuar më kandidatin tjetër. E kuptoj gadishmerrin e juaj për të zgjidhur këtë çështje, ju falënderoj për këtë. MAVL-ja nuk është bazuar në një ligj ose nen, kur keni kërkuar përgjigje nga ata. Ata e kanë dhënë vetëm mendimin e tyre, dhe mendoj që këto janë mendimet të transparente, ka dhënë mundësi që dy subjektet politike mirën vesh. Ne nuk e kemi arit marrëveshje, mendoj që kjo situata duhet të zgjidhet me short, pasi nuk mundemi të bëjmë

një marrëveshje. Mënyra e tjetër mundet vetëm më qenë të gabuar edhe vetëm të komplikon situatën. Nëse një palë nuk është e kënaqur, mundet pastaj me u ankua në Ministri dhe ata munden pastaj me shkyqezuar këtë vendimi. Mendoj që nuk ka nevojë të bëjmë pauzë, po shkojmë direkt më short, që në këtë mënyrë mundemi të zgjedhim këtë situatën.

**Predrag Grbic:** Të gjitha vendime të cilët i aprovohet në Kuvend, dërgohen në MAVL, dhe në kuadër e asaj Ministri ekziston komisioni për shqyrtimin e ligjeshmërisë së vendimit. Fjalën e fundit, a është vendimi që kemi marrë na, në përputhje me ligjin apo jo, e jep komisioni, dhe Ministria do të na informon. Ne do të mundohemi që këtë vendimin për zgjedhjen të zëvendësit të kryesuesit të sjellim në përputhje me disa parimet e caktuara demokratike. Asnjëherë nuk do të imponoj vullnetin tim, besoni që askush në komunë nuk dëshiron në këtë rast që të ju imponon vullnetin e tij. Për ata ekziston Kuvendi, si një institucioni që ka për derr të zgjidh disa gjera, ose me votim, ose në përputhje me ligjin. Në këtë rast, propozimin të cilin e kemi marrë nga ministria, nuk ekziston në ligjin, por ky është mendimi i tyre, propozimi i tyre se si ne të dalim prej këtij problem. Hapi diskutim lidhur me këtë, dhe dua të dëgjoj mendimin e këshilltareve. Do të merrni fjalë z. Rifat, por do të doja të dëgjoj edhe mendimin e disa këshilltareve të tjerë.

**Rifat Rustemi:** Nuk jam kundër se dikush të jep një mendim, mundet me kon një marrëveshje paraprake, sepse e dimë që Lista serbe dhe PDK e kanë shumicën, edhe unë jam këshilltar i vetmi këtu. Unë kërkoj që të hellet shorti. Sepse ky është edhe mendimi i ministrisë, besoj që nuk do të bëhet asnjë shkelje, dhe nëse e bëjmë shkelje, prapë ministri do të jep mendimin për të zgjedhur më një meny tjetër dhe pastaj ta kërkojmë ankesa. Nuk ka nevojë nëse dëshirojmë me qenë transparente, jeni deklaruar ju dhe kryetari edhe krejt dhe mendoj që është mirë të shkojmë më short sepse ajo është fati. Nëse zgjidhet Gripi ja uroj, nuk ka asnjë problem. Nuk ka nevojë me përdor metodën tjetër.

**Predrag Grbic:** Nuk ka problem, për mua nuk ka rëndësi kush do të bëhet zëvendësi i kryesuesit, mu vetëm më intereson që ky institucioni ka një zëvendës. Keni shprehur qëndrimin e juaj, dhe unë e respektoj, por unë kam hapur diskutimin, a lajmërohet dikush për fjalë.

**Blerta Hazizi:** Unë e propozoj që zëvendësi i kryesuesit për komunitete zgjidhet nga anëtarët e këtij Kuvendi.

**Predrag Grbic:** A lajmërohet edhe dikush tjetër për fjalë? Nuk lajmërohet askush. Kemi propozim të Ministrisë, marrëveshje politike, e cila për fat të keq nuk është aritur, dhe propozimi i dytë nga ministria, që nepermjet shortit të zgjidhet zëvendësi i kryesuesit, dhe kemi një propozim e këshilltares, që zëvendësi zgjidhet me votim. E qes së pari në votim propozimin e Ministrisë, ajo është që zëvendësi i kryesuesit zgjidhet nepermjet shortit, dhe vetëm të përsëriti, këtu shkruan zgjidhje sepse ne duhet të zgjidhmi, më pas pasur këshilltarin më mëshomë vota, në seancën e parë e kishim shkruar emërimi, për ata që me ligj është cekur që zëvendësi i kryesuesit emërohet. Kush është për ata që kryesuesi zgjidhet me short?

Kush është që zëvendësi i kryesuesit zgjidhet me votim?

Konstatohet se 14 këshilltar kanë votuar që zëvendësi i kryesuesit zgjidhet me votim, 1 këshilltar ka votuar që zëvendësi zgjidhet me short

**Rifat Rustemi:** Nëse e vendosni që të zgjidhni më shumicën parlamentare, a mundeni më ma dhënë një përgjigje, pse keni pritur seancën e tretë, pse nuk e keni zgjedh në seancën e parë. Pse ke prit tri seanca. Sepse e keni pasur zgjidhje, nuk ka pasur nevojë të presin mendimin e ministrisë. Së kini pasur nevojë me hup kohë.

**Predrag Grbic:** Ju po harroni ato çka kam thënë, këtu nuk zgjedhi unë, zgjedh Kuvendi, kjo është një gjë shumë e rëndësishme, unë nuk dua që të imponoj vullnetin tim, as vullnetin e Ministrisë e cila ka dhënë mendimet e bazuar në nuk di në çka, por sigurisht jo në ligj. Sipas meje

më e mira është, pasi bëhet puna për institucion e cilin e përfaqësojnë 15 këshilltar, që ata të vendosin si të bëjmë. Unë e kam pritur marrëveshje në mes jush, për ata në dy seanca të para nuk e kam vendosur këtë pik në rendin e ditës. Për mua kish qenë më mirë që kishim pasur zëvendësin e kryesuesit, ashtu që ju kishin pasur një marrëveshje në mes juve, por unë kam qenë prezent kur keni biseduar edhe nuk keni bërë asnjë kompromis. Më vjen shumë keq, por unë duhet të marrë këtë hap. Sipas meje nuk ka kundërshtim, a do të jetë vendimi përfundimtar i cilin ne e marrim këtu a do të jetë në përputhje me ligjin a jo, kam thënë ekziston komisioni e Ministrisë për shqyrtim e ligjshmërisë së vendimeve dhe në afat prej 20 ditës do të dimë përgjigje, detyra ime është që në afat prej 7 dit e nënshkruaj vendimin dhe të dorëzoj në Ministri. Dhe pastaj Ministria pas 14 ditës të jepë një përgjigje nëse vendimi është në përputhje me ligj. Nëse është në përputhje me ligj, ne nuk e marrim asnjë përgjigje nga ministria. Ashtu që në afat do të dimi përgjigje. Pasi në pyetje është votimi, kemi dy mundësi, votimi i fshehur dhe publik. A lajmërohet edhe dikush prej këshilltareve më një propozim tjetër, ose që donë me thotë diçka lidhur me këtë votim? Pasi askush nuk lajmërohet, e qes në votim, kush është që zëvendësi zgjidhet me votim publik? Kush është që zëvendësi zgjidhet me votimin e fshehur?

Konstatohet se 14 këshilltar kanë votuar që të votimi është e fshehur, 1 këshilltar nuk ka votuar para zgjedhjes së komisionit unë kisha dhënë një pauzë e shkurtër për të përgatit këtë votimin e fshehur

Seanca vazhdon me punë pas pauzës

**Predrag Grbic:** Pasi kemi marr fletët e votimit, këtu është edhe një kutia, tani duhet të formojmë komisionin, unë propozoj dy këshilltare e komunitetit shqiptar te cilat nuk janë kandidatë për zëvendësin e kryesuesit për komunitete, znj. Arita Selimi dhe znj. Blerta Hazizi janë anëtarët e komisionit, dhe z. Dragomir Stanisavljevic të jetë anëtar i komisionit. A ka dikush një propozim tjetër? Pasi askush nuk lajmërohet për fjalë, e qes në votim këtë propozim.

Konstatohet se 14 këshilltar kanë votuar për, një këshilltar nuk ka votuar

**Rifat Rustemi:** Dua të di kryesues në atë fletëvotim a gjendet emri im, a jo, unë nuk pranoj që jam pjesë e këtij votimit, lirisht hiqni emrin them, leni vetëm një emër konin doni të zgjidhni ju, pasi keni pranuar këtë formë, nuk ka nevojë që emri im gjendet në këtë fletëvotim.

**Predrag grbic:** Tani pasi kemi qit propozimin për të votuar, ju po thoni që nuk doni që emri i juaj gjendet në fletën e votimin dhe ato gjatë votimit. Ato keni dashur të tregoni para së kemi shtypur fletët e votimit, fletët janë shtypur. Kuvendi është tu votuar, vetëm mundem të pranoj refuzimin e juaj, nëse ju zgjidhni për zëvendësin, fletët janë këtu kemi dy kandidat dhe në duhet të votojmë. Pasi ka përfunduar votimi, e lus komisioni që të numëron vota.

Rezultati i votimit është:

Grip Sahiti 13

Rifat Rustemi 0

Fletët pavalleshme 2

Në bazë të votimit z. Garip Sahit është zëvendësi i kryesuesit e KK Shtërpce, Urime për zgjedhjen tuaj.

#### 4. Shqyrtimi dhe aprovimi i raportit vjetor i punës kryetarit

**Predrtag Gbic:** Raporti i punës së kryetarit është obligimi i Kuvendit, ai është dy here në vit është para këshilltareve. Në pjesën e par raportit është ajo që ka qenë qëllimi i udhëheqjes së komunale në vitin 2017, pastaj në pjesën e dytë raportit janë raportet të Drejtorive të cilët veprojnë në komunën e Shtërpçës. Hapi diskutim

**Rifat Rustemi:** Sa për këtë raport unë kam lexuar më vanës dhe edhe kam nënvizuar do vërejtjet e mia. Në faqen 2 bëhet fjala për investime në trashëgimi kulturore pa dallime. Nuk e di për pjesën e serbe, e di vetëm që ka pasur disa investime në kishat ortodokse nga komuna. Na kemi gjamin në f. Firaja e cila është në rrënimin e sipër edhe nuk e di a ka ndërmarr komuna diçka deri tash. Të faqja 4 e raportit të sektori i shërbimit ofiqaris thuhet që janë kryer shërbime në të gjitha qendre, në Shtërpce në Drakovc..., po flas për qendrën në Brod të cila një kohë gjatë nuk ka funksionuar, andej të shpenzimet e karburantit, kemi 10861 L dizell, benzinë 9010 L dhe Plin 220 L, nëse llogaritmi në total del 20091 L dhe nëse e qëndrojmë në kilometra për një dit punës del që janë shpenzuar 83 L, nëse e qëndrojmë në kilometra del 1000 km për një dit pune. mendojnë që janë shumë për komunën Shtërpce, tu e marr parasysh buxhetin që e ka. Në faqen 6 thuhet sa e përket kërkesave për qasje në dokumente publike komunës së Shtërpçës në përdh janar –dhjetor 2017 janë parashtruar 5 kërkesa. Parashtruesit e kërkesave përgjigje kanë marr në afatin ligjor. Kështu shkruan atje, unë mendoj që kjo nuk qëndron, sepse ne mesin e këtyre 5 kërkesave është edhe dokumenti që e kam unë këtu, i cila është kërkesa e Lëvizjes Vetëvendosje në Shtërpce e protokolluar më datën 04.04.2017, dhe Lëvizja Vetëvendosje nuk e ka marr përgjigje as negative as pozitive për këtë kërkesën. Nëse doni mundem më dhënë ka një kopje këshilltareve. Pastaj të shërbimi kadrovik faqe 9 dhe 10, këtu precizohet stafi personeli komunës, 108 të punësuar, preja tyre 71 serb dhe 37 shqiptar kjo është në rregull, por sa për punësimin gjinor, janë 24 femra edhe 81 mashkull, nëse e kthejmë në përqindje i bijën 25.29%, do më thonë që nuk është respektuar kuota gjinore. Kryetari i komunës është tani mandatin e tret, dhe ka mundur më bërë diçka mëshomë në këtë aspekt. Të shërbimi publik faqja 11, në të gjitha procedura e tenderimeve kushti ka qenë çmimi më të ulët, për dhënien e kontratës të gjitha janë në rregull, por edhe mbikëqyret duhet më qenë në nivel, sepse nuk duhet më këqyr vetëm çmimin, por varet si po bëhet puna dhe duhet me pas mbikëqyrje Faqe 14 drejtoria së bashku më ndërmarrjen komunale nga Shtërpce, ka realizuar aksionin e pastrimit të gjitha varrezave në komunë si dhe shesheve në të gjitha vendbanime, unë nuk e di që në pjesën e shqiptareve deri tani komuna ka ndërmarr aksionin e pastrimit të varrezave, mirëmbajtjen ose rrethimin e tyre, për pjesën serbe nuk flas sepse nuk jam informua, mendoj që duhet të bëhet më shumë në këtë drejtim. Kjo është esenca kryesore, falënderoj.

**Radojka Repinovic:** Detyra e kryetarit e komunës së Shtërpce është që të shërbejë qytetarëve, dhe që të organizon sa më të mirë këto shërbime. Njëri nga prioritetet është nxitja e vetëpunësimit, dyta është ndikimi në sigurimin e situatës ekonomike në komunën e Shtërpce, përmirësimi i situatës ekonomike dhe krijimi i vendeve të ri punës, është procesi i cili vazhdon dhe cili duhet më pas vazhdimësi. Nga ky raport çart shihet që vazhdimësia po vazhdon të jetë përpjekje e madhe. Komuna e ka bërë në përmirësimin e situatës ekonomike, duke e regjistruar projektet të ndryshme të cilat e mundësojnë ato, ishte pjesëmarrjese aktive në të gjitha proceset të cilit ndikojnë në stabilizimin dhe prosperitetin e jetës së banoreve të komunës së Shtërpçës. Ju falënderoj për këto informata në këtë raport dhe propozoj aprovimin e tij.

**Predrag Grbic:** Njëra nga pyetje të cilin e keni parashtruar z. Rifat është e lidhur me Administratën, por sot drejtori më arsyë nuk është këtu, ashtu që përgjigje për këto pyetje do të marrin në Kuvendin e ardhshëm. Sa i përket varrezave në komunën tonë, ato e keni pyetur edhe

në kuvendin e kaluar, dhe atëherë kemi marrë përgjigje nga drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, që në të ardhmen do të rregullohen varetat në të dy komunitete. Sa i përket Prokurimit Publik, këtu nuk është askush nga prokurimi. Pajtohem më ju që mbikëqyrje është njëra nga gjerat shumë të rëndësishme, të cila direkt ndikon në kualitetin e punimeve të cilët zhvillohen në komunën tonë, kështu që do të tërheqim vëmendjen për këtë detaj. Dhe deri tani ka pasur mbikëqyrje e mirë, por nëse ka disa pjesa për përmirësim, duhet pak mëshomë të punohet në atë drejtim.

**Rifat Rustemi:** Në lidhje me këtë kërkesë këtu kërkohet lista e pagave dhe në raportin e kryetarit janë përgjegjësi, drejtorja e shëndetësisë thuhet se shëndetësia sekondare dhe primare. Sekondare nuk përmendet në raportin kryetarit, a në raport shpenzimeve ceket që ka shpenzime në shëndetësi sekondare, a në raportin në kemi kërkuar listën e pagave e punëtorëve spitalit. Unë mund të them që në komunën e Shtërpçës ka korrupsion keqpërdorimi i parave taksapaguesve e republikës së Kosovës punësohen punëtor, ata marrin pagat a nuk punoj kjo është antiligjore dhe kjo ka filluar në vitin 2011 thuhet që janë marr mjete speciale dhe janë paguar kaq, dhe pastaj janë vjedhur, nuk jep llogari askush keqpërdorimi më i madh në komunën e Shtërpçës po ndoll lidhur me çështjen e spitalit, edhe duhet të gjemi një zgjidhje sepse nuk bon më vazhdua kështu.

**Predrag Grbic:** Spitali është një pyetje për veti. Që të fillon më funksionim spitali nevojitet shumë paisje, dhe me buxhetin e komunës së Shtërpçës, është shumë e vështirë që sigurohen ato mjete. Udhëheqësi e komunës punon për këtë, dhe çdo vit spitali është i furnizuar më shumë me atë që nevojitet për të filluar punën. Për pyetje të tjera do të merrni përgjigje në Kuvendin e ardhshëm nga drejtori i administratës, sepse ai është përgjegjës për këtë. Pasi nuk lajmërohet askush tjetër e qes në votim këtë pikë.

Konstatohet se 14 këshilltar kanë votuar për, një këshilltar nuk ka votuar

## **5. Prezantimi i raportit përfundimtar financiar i kryetarit për vitin 2017**

**Danijel Vuksanovic:** Raportin e ka përgatitur menaxheri i kontabilitetit në formën standarde dhe është paraqitur në 16 faqe. Komuna e Shtërpçës ka 16 programe buxhetore dhe 5 kategori të shpenzimeve, ato janë: pagat, komunali, mallra dhe shërbime, subvencione dhe projekte kapitale. Nga faqja 1 deri 13 keni dhëna për secilin program buxhetor, dmth. shpenzimet veç veç, në faqen 14 keni shpenzimet totale buxhetore për të gjitha 16 programe buxhetore, në faqen 15-16 keni listën e detyrimeve të cilët i ka komuna më datën 31.12.2017. Në vazhdim keni edhe dy tabele, lidhur me hyrat vetanake. Buxheti përgjithshëm përmbahet nga grandit qeveritar dhe të hyrat vetanake, këto tabelat kanë lidhje më planin, ajo që është planifikuar për vitin 2017, dhe sa është arritur. Tabela e dytë është krahasimi i të hyrave vetanake të realizuar deri në vitin 2016. Buxheti për vitin 2017 ka qenë 3.577.609€, nga të cila 55% ka shkruar për pagat, 10% për mallra dhe shërbime, 2.28% për komunali, 0.08 në subvencione dhe 33% për investime kapitale. Këto janë disa të dhëna bazë lidhur më këtë raport, nëse dikush ka një pyetje, unë jam këtu për t'u përgjigjur.

**Rifat Rustemi:** Sa për këtë raport financiar vetëm diçka nuk e kam kështu pasi është drejtori këtu ndoshta e shpjegon. të kërkoj kategori të buxhetit është njëjtë alkimi si buxheti, alokime janë 1200€ edhe shpenzimet janë 1200€, prej kësaj kategori vetëm në tre rubrika ka ndryshime prej asaj. Po besoj që nuk mundet me kon e njëjtë, duhet alokime më kon ose mëshomë si ka qenë buxheti, ose më pak, nuk mundet më qenë fikse. Në faqen 6 të hyrat vetanake për vitin 2017 kemi, të Zhvillimi Ekonomik që buxheti është 1000€ a alokime, fjala është të mirëmbajtja

inventive 80514€buxhet, 453486€ është alkimi edhe 35200 janë pa flokuar, vetëm kjo ndryshon të krejt tjera kategori është sa ka pasur buxhet ka pasur alokime. Un nuk kuptoj si mundet me qenë buxheti i njëjti më alokime. Edhe të shëndetësia sekondare janë bërë shpenzime të pajiset specializuar medicinale, janë dy kategori 27000€ njëra, tjetra është 314000€ edhe janë dhe pagat 1114000€ rryma edhe tjera, janë shpenzimet maramence dhe ne e dimë që spitali nuk punon edhe nuk e di si bëhen ato shpenzimet e rrymës dhe mbeturinave kur nuk ka njerëz pak është interesant, më mirë është që të shpenzojmë ato mjete për në investim tjetër. Unë për këtë raport nuk mundem më thonë që është raporti i detajuar.

**Radojka Repinovic:** Prezantimi i raportit financiar është në detajet në të gjithë 16 programt e buxhetit. Në kornizën këtij programit buxhetor janë paraqitur 5 kategori shpenzimeve. Të gjitha ato janë klasifikuar sipas kategorive ekonomike dhe përfaqesojnë totalin e tyre për këtë periudhë. Nga raporti po shihet se mjetet janë shpenzuar në përputhje me ndarjet buxhetore për vitin 2017, dhe që kujdeset për disiplinën buxhetore në ardhmen.

**Predrag Gbic:** Kur fjala për buxhetin, nuk varet nga ne, kjo varet nga financa, që ata japin sugjerimet e tyre për miratimin e par buxhetit, ne po përpiqemi që të miratojmë buxhetin sipas nevojës së komunës tonë.

**Danijel Vuksanovic:** Këtu ka qenë fjala për zhvillimin ekonomik, në faqen 6, buxheti është planifikuar, këtu flitet për hyrat vetanake, por, nëse keni vërejtur në prezantimin e mëparshëm kam thënë se kemi planifikuar hyrat vetanake për vitin 2017 në vlerë prej 446.914€, por, ne kemi mbledh 247.449€, ose 55%. Për shkak të kësaj diferencës që ne nuk e kemi mbledh, për ata këtu ka dallim në mes të buxhetit fillestar dhe alokimeve. Të gjitha të hyrat e mbledhura gjatë muajve të ardhshme ne e ndajmë ato dhe i japim drejtoreve e drejtorive për të disponuar ata më këtë. Unë shpresoj që isha i qartë. Sa i përket shëndetësisë sekondare, spitali ka 523.271€, shpenzimet ndahen për pagat, komunali, mallra dhe shërbime dhe projektet kapitale. Pajisje speciale mjekësore janë të fundit në tabelën e parë, kjo është shuma prej 304,313€, ne atëherë kemi blerë pajisje, pajisje janë në spital, ne përpiqemi që në çdo vit, sa kemi mundësi të pajisemi spitalin, për të shtirë funksionin. Pajisje që ka vlerën më pak si 1000€ paguhet nga mallrat dhe shërbimet, ashtu që e kemi atë shumën nga 27.000€, mbi 1000€ paguhet nga projektet kapitale.

**Rifat Rustemi:** Falënderoj për përgjigje, kisha pasur dëshirë që ne si përfaqësuesit e popullit, të qoftë si kuvend qoftë si këshilltar e kuvendit, të vizitojmë objektin e spitalit në të cilin kanë filluar investime nga viti 2010, dhe marrin rrogën njerëzit që po rin në shtëpi, dhe më pa ato pajisje me pa çka po funksionon a çka jo. A bon me dit ne si përfaqësuesit e popullit kur do të fillon më funksionimi spitali a ndoshta nuk do të funksionon kur, vetëm do të keqpërdoret buxheti i taksapaguesve, tu e paguar punëtor e cilit rin në shtëpi, dhe tu e vjedh pajisje, dhe nuk të përgjigjet askush.

**Predrag Gbic:** Z.Rustemi kur flisni për vjedhje, është një fjalë shumë serioze, sepse për ata duheni me pas fakte. Nuk mundeni në një institucion serioz si kjo të thëni diçka të tillë. Nuk dua që në këtë mënyrë diskutohet këtu. Unë e kuptoj shqetësimin tuaj, ju keni drejt të jepni mendimin e juaj, askush nuk e mohon mendimin e juaj as qëndrimin e juaj. Kur është fjala për spital, komuna e Shtërpçës në bazë të Planit Ahtisarit dhe ligjit për vetëqeverisje lokale, përveç Mitrovicës dhe Graçanicës nga mjediset e serbe, edhe ne kanë drejt për shëndetësi sekondare, por, nuk do më thonë që ne kemi drejt të kemi shëndetësinë sekondare që menjëherë duhet të hapim spitalin. Funksionimi i spitalit varet shumë nga mjetet të mjaftueshme të cilët duhet të

kemi për të vënë në funksion një institucion e tillë, i cili do të afrohet shërbimet qytetareve. Nuk është spitali ndërtesa, mjekët ose infermiere, spitali duhet të ketë nevojshme për një funksionim e mirë. Në prill, në raportin tremujor do të merrni të gjitha informacionet për mjete të shpenzuara për shëndetësi sekondare, lidhur me furnizim me pajisje për funksionimin normal të spitalit. Sa i përket vizitës së spitalit, nuk e ka asnjë pengës. Komuna e Shtërpçës në disa raste është shpërbluar për transparencë dhe komuna në çdo vit ka 4 raportet financiar të cilat janë në dispozicion të qytetareve, për ata që ne jemi transparent, dhe ekziston edhe auditivi të cila vjen çdo vit në komunën tonë, dhe ata kanë qasje në çdo dokument që kërkojnë. Kuvendi dhe Udhëheqja komunale shumë mire bashkëpunon me auditoret. Të gjithat që kërkojnë, është obligimi dhe vullnet ynë që të jepmi, si dëshmi i punës. Ata në atë meny munden të shohin a ka mashtrime për të cilët ju pretendoni që ka.

**Rifat Rustemi:** Sa e përket vjedhjeve, është e vërtetë se ka organet të cilët janë kompetent për Këtë. Unë e di që ka qenë në media, që ka pasur vjedhje dhe sipas listës janë të punësuar 25 punëtor, të cilit e marrin pagat. Më marr pagën dhe mos me krye asnjë shërbim është antiligjore. Sa për pajisje mendoj që është në rregull që komuna e blen sipas mundësive, shpenzimet e rrymës dhe mbeturinave janë shumë të anormale, edhe nuk janë e arsyeshme. Nuk është mirë çdo here kur janë zgjedhjet të hapet konkurset për pranimin e punëtorëve në spital, a ata nuk e kryen asnjë shërbim, as nuk e din ku i kanë zyrën. Kjo është pak kontradiktore.

**Predrag Grbic:** A lajmërohet edhe dikush për fjalë pasi kjo pika nuk votohet, kalojmë në pikën e ardhshme.

## 6. Shqyrtimi dhe aprovimi i planit të punës së Kuvendit për vitin 2018

**Predrag Grbic:** Në Kuvendin e kaluar ne kemi formuar një komisionin për hartimin e Planit të punës së Kuvendit, dhe ata janë takuar gjatë këtij muaji dhe kanë aprovuar këtë Plan të punës, të cili mundet të ndryshohet në Kuvendin e sotshëm. Ajo që është më e rëndësishme në Planin e punës është që atë gjinden të gjitha që janë obligimi ligjor. Nëse dikush ka një propozim për të vendosur, që në muajve e ardhshme duhet të gjendet në rendin e ditës, mundet të propozon, na do të qesim në votim, dhe nëse aprovohet, atë here do të futet në rendin e ditës.

**Rifat Rustemi:** Edhe sepse kam qenë i propozuar për punimin e planit nuk kam pasur mundësi me marr pjesë, sepse nuk kam qenë në Kosovë e di që kjo nuk është definitive kjo vetëm është më pas një orientim. Unë kisha propozuar së paku edhe një seancë solemne, që mbahet në fund vitit, edhe kjo më qenë e parapamë më plan, ky është propozimi im.

**Predrag Grbic:** Nëse e keni lexuar Planin e punës, atë shkruan që në muaj nëntor formohet komisioni për hartimin e planit të punës, dhe aprovohet në dhjetor. Por, pasi zgjedhjet kanë qenë në nëntor, në dhjetor kemi pasur seancën e inauguruese, atë here na ka mbetur që në janar e formojmë komisionin, dhe në shkurt e aprovojmë rendin e ditës.

**Ivica Tanasijevic:** Këtu është cekur që kemi planifikuar më këtë Planin e Punës që raporti i punës së Komitetit për Siguri në Bashkësi për muaj shkurt, por, duke marr parasysh që raporti nuk ishte i gatshëm, propozoj që raporti shtuhet për seancën e ardhshme të Kuvendit, dmth, për mars. Dhe kisha shtuar dhe pikën e përfundimit të komitetit për siguri në bashkësi, duke marr parasysh që mandati Komitetit për siguri në bashkësi

**Predrag Grbic:** Kemi marr njw propozim lidhur me Komitetin për siguri, nëse askush nuk donë me marr fjalë, se pari kish vendos ne votim propozimin e z. Ivica tanasijevic. Kush është për këtë që kjo pika futet në Planin e punës për muajin mars?

Konstatoj se me njëzëri kemi aprovua këtë pik

#### **7. Propozimi i vendimit për bartje e hyrave vetanake pa shpenzuar nga viti 2017 në vitin 2018**

**Danijel Vuksanovic:** Ajo që është më e rëndësishme këtu është se ky është njëvendim ligjor dhe detyrim. Fjala është për shumën 135.314€, e cila lidhet kryesisht me projektet kapitale. Nese e miratojmë këtë vendim dhe transferojmë mjete, buxheti do të ritet për vitin 2018, për këtë shumë e cilën kam përmendur.

**Rifat Rustemi:** Si është e mundshme që nuk janë shfrytëzuar 135000€ Ato janë shumë tu e dit nevojat e komunës së Shtërpçës.

**Predrag Grbic:** Grumbullimi e hyrave vetanake nuk varet prej udhëheqëses së komunës, as prej administratës, as prej drejtorit e financave, por varet prej qytetareve. Qytetaret e paguan detyrimet e tyre në fund të vitit dhe atëherë është vonë që të shpenzohen ato mjete në atë vit, për ata transferohen në vitin e ardhshëm. Pasi nuk lajmërohet askush e qes në votim këtë pik/  
Konstatoj se me njëzëri kemi aprovua këtë pik

#### **8. Të ndryshme**

**Predrag Grbic:** Do të doja të them diçka, fjala është për formular për deklarimin e pasurisë, dmth. raportin i cili dorëzohet në Agjencisë kundër ryshfetit dhe korrupsionit. Këshilltar e rinj kanë dorëzuar deklaratat e tyre, sepse detyra e tyre ka qenë që të dorëzojnë deklaratën brenda një muaj pas dhënies e betimit. Por në këtë parlament lokal kemi edhe këshilltar nga përmbajtja e mëparshme, kështu që ata duhet të bëjnë deri data 30 mars. Nëse ju doni vet me dorëzua atë deklaratën në agjenci. Nëse doni që na të bëjmë ato, dorëzoni ato deklaratat deri 20 mars në zyrën e administratës, dhe ne do të dërgojmë për të gjithë ne në agjenci, sepse kjo është shumë e rëndësishme, sepse dënimi për mosrespektimin e kësaj është shumë e lart. E lus këshilltar që të respektojnë afatin të cilin e kam cekur për mos me ndoll që të paguan dënimin.

**Rifat Rustemi:** Dashuroj të ngriti një qeshte, në javën e kaluar kemi pasur një gjëbajtje e një fermerit e f. Brod komuna e Shtërpçës, e di që kjo nuk është çështje institucioneve lokale. Tu e pas parasysh që komuna e Shtërpçës është me favor, sepse kemi një zëvendës ministër i cili vjen nga kjo komuna 2-3 deputet, kemi nënkryetarin e pushtetit lokal i cili është zëvendës ministri prek kësaj zonës, kisha kërkuar prej juve dhe të gjithë institucioneve lokale që të zgjidhni këtë çështje, pasi nuk mundemi më ndihmuar fermerët tonë me subvencione, se pakti mos e marrin gjoba dhe duhet të zgjidhet ky problem, duhet sepse ky problemi është i shqetësues, dhe duhet të gjejmë një zgjidhje në mes institucioneve lokale dhe qendrore. Na e dimë që demin më të madh e pyjeve e Sharit ka bërë shteti edhe institucionet lokale dhe qendrore, që në manuren e organizative e kanë shitur. Nuk e kanë bërë dhiti e ati fermerit i cili u gjobit me 300€

**Predrag Grbic:** Ne jemi njoftuar me këtë problem dhe askush nuk është pajtuar më të. E dimë se një pjesa e banoreve ton jeton vetëm nga blegtori, dhe është e logjike që bagëtie e tyre dërgon për kullosje në livadh, pyll ose diku tjetër, kjo nuk është prerja e pyllit, veç është diçka që është logjike për ata që merren më blegtori. Është e palogjikshme që të dënohen për ata. Jemi

pajtuar për këtë, ashtu që kryetari për komunitete do të zgjedh këtë çështje , dhe do të bisedon me njerëzit nga Parku kombëtar, pasi ata e kanë filluar iniciativën për këtëj njërit i cili merret me blegtori , dhe do të bisedon më të gjithë ata që janë kompetent për këtë fushë, mos me ndoll kjo asnjë banorit e komunës ton në të armen. A lajmërohet edhe dikush për fjalë. Pasi nuk lajmërohet askush seanca e dytë e sotshme ka përfunduar, ju falënderoj në pjesëmarrjen.

**Procesmbajtësi**  
**Staja Markovic**

---

**Kryesuesi i KK**  
**Predrag Grbic**

